Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administratës Publike
Ministarstvo Javne Uprave - Ministry of Public Administration
Enti i Statistikës së Kosovës – Zavod za Statistiku Kosova – Statistical Office of Kosovo

Seria 3: Statistikat Ekonomike

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (TM1 – 2011)



P r i sh t i n ë
2 0 1 0

Enti i Statistikës së Kosovës
Zavod za Statistiku Kosova
Statistical Office of Kosovo

P a r a th ë n i e

Enti i Statisikës së Kosovës (ESK), gjegjësisht Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare ka filluar të publikoj Indeksin e çmimeve të prodhimit (IÇP) nga muaji Maj 2009.

Çmimet dhe vlera e prodhimeve indusriale janë grumbulluar nga ndërmarrjet prodhuese më ndikim në Kosovë. Vlera e prodhimit dhe çmimi mesatar vjetor i referohen vitit 2007, ndërsa nga tremujori i parë i vitit 2008, është duke u bërë monitorimi dhe llogaritja e indeksit në vazhdimësi, në periudha tremujore dhe vjetore

IÇP - Indeksi i çmimeve të prodhimit është në përputhshmëri me Klasifikimin Standard të Veprimtarive sipas NACE rev.1, është në zhvillim e sipër dhe synon të përfshijë në vazhdimësi aktivitete ekonomike të cilat për momentin nuk janë aktive, por, gradualisht pritet prodhimi nga këto aktivitete.

Komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet tuaja lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe ato të dërgohen në adresën elektronike: economic@ks-gov.net

Ky publikim është përgatitur nga:

Ilir T. Berisha - Drejtori i Departamentit
Ibish Asllani - Shef divizionit
Hamdi Jupolli - Shef Sektori
Raif Gashi - Zyrtar i lartë
Hasan Berisha-Zyrtar i lartë
Arlinda Mataj – Zyrtare e lartë

Korrik, 2011

u. d i Kryeshefit Ekzekutiv i ESK-së,
Isa Krasniqi

Simbolet dhe Shkurtesat

IÇP	Indeksi i Çmimeve të Prodhimit
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
NVE	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike
TM1	Tremujori i parë
TM2	Tremujori i dytë
TM3	Tremujori i tretë
TM4	Tremujori i katërt

:	Shfra nuk është disponibël
0	Më pak se gjysma e njësisë së përdorur
-	Nuk aplikohet
%	Përqindje
W	Ponderët statistikor (pesha specifike)
Ø	Mesatare

P ë r m b a j t j a

Faqe

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) për Tremujorin e parë - 2011 5

Tabela 1: Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) TM1 2008 - TM1 2011 (2007=100),

ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje 6

Figura 1:Zhvillimi i IÇP, TM1 2008 – TM1 2011 7

Tabela 2: Peshat, Indeksi i çmimeve të prodhimit (2007=100) dhe indekset me bazë kuartale..... 8

Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) për tremujorin e parë - 2011

Indeksi i çmimeve të prodhimit në Kosovë u ngrit për 3.1 % në mes të TM4 2010 dhe TM1 2011. Krahasuar me TM1 2010 çmimet e prodhimit u ngritën në një mesatare për 10.6 %.

Tremujori i katërt 2010 – Tremujori i parë 2011 3.1 %

Çmimet e prodhimit në Kosovë janë ngritur në një mesatare prej 3.1 % në mes të TM4 - 2010 dhe TM1 - 2011. Ngritje më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen të industria e produkteve ushqimore dhe e pijeve (9.7 %), te prodhimi i produkteve prej metaleve përveq makinave dhe pajisjeve (5.3 %) dhe prodhimi i kemikalive dhe produkteve kimike (3.0 %).

Ngritja u neutralizua nga rënia e çmimeve te prodhimi i produkteve prej gome dhe plastike (-6.9 %), punimi me dru dhe fabrikimi i artikujve prej druri (-5.5 %) dhe prodhimi i metaleve (-1.6 %).

Tremujori i parë 2010 - Tremujori i parë 2011 10.6 %

Çmimet e prodhimit në Kosovë janë ngritur në një mesatare prej 10.6 % në mes të TM1 - 2010 dhe TM1 - 2011. Ngritjet më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike ishin te nxjerrja e mineraleve metalike (71.6 %), industria e produkteve ushqimore dhe e pijeve (21.7 %), industri të tjera nxjerrëse (10.5 %), prodhimi i mjeteve të tjera të transportit (7.7 %), prodhimi i makinave dhe pajisjeve (4.7 %), prodhimi i produkteve prej metaleve përveç makinave dhe pajisjeve (3.4 %) dhe prodhimi i kemikalive dhe produkteve kimike (2.5 %).

Ngritja u neutralizua nga rënia e çmimeve te prodhimi i produkteve prej gome dhe plastike (-3.0 %), prodhimi i makinave dhe aparateve elektrike (-1.6 %) dhe prodhimi i produkteve minerale jo metalike (-1.1 %).

Tabela 1: Indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) TM1 2008 – TM1 2011 (2007=100), ndryshimet tremujore dhe vjetore në përqindje

Viti	Tremujori	Index (2007=100)	Ndryshimi tremujor në (%)	Ndryshimi vjetor në (%)
2008	TM1	101,2	:	
	TM2	101,4	0,2	:
	TM3	102,3	0,9	:
	TM4	100,3	-2,0	:
	Mesatarja vjetore 2008	**101,3**	**:**	:
2009	TM1	101,3	1,0	0,1
	TM2	106,4	5,0	4,9
	TM3	106,4	0,0	4,0
	TM4	106,5	0,1	6,2
	Mesatarja vjetore 2009	**105,2**	**:**	**3,8**
2010	TM1	106,7	0,2	5,3
	TM2	108,0	1,2	1,5
	TM3	111,3	3,1	4,6
	TM4	114,5	2,9	7,5
	Mesatarja vjetore 2010	**110,1**	**:**	**4,7**
2011	TM1	118,0	3,1	10,6

Figura 1: Zhvillimi i IÇP, tremujori i parë 2008 – tremujori i katërt 2010



Tabela 2: Peshat, indeksi i çmimeve të prodhimit (2007=100) dhe indekset me bazë tremujore

Kodet	Nomenklatura e veprimtarive ekonomike NVE rev.1	Peshat	TM1 - 2011	TM1 - 2011	TM1 - 2011	IQP - 2010
			Ø2007=100	TM4 - 2010	TM1 - 2010	(2007=100)
	Gjithsej IÇP	1000	118,0	103,1	110,6	110,1
10	Nxjerrja e qymyrgurit, linjiteve dhe shtresave të varfëra të mineralit	1,8	100,0	100,0	100,0	100,0
13	Nxjerrja e mineraleve metalike	54,7	171,6	100,0	171,6	137,0
14	Industri te tjera nxjerrëse	23,4	112,9	100,0	110,5	106,0
15	Industria e produkteve ushqimore dhe e pijeve	244,1	126,1	109,7	121,7	107,7
19	Përgatitja, tanini i lëkurës, prodhimi i artikujve të udhëtimit dhe të galanterisë, prodhimi i pajimeve të kuajve dhe prodhimi i këpucëve.	1,7	100,0	100,0	100,0	100,0
20	Punimi me dru dhe fabrikimi i artikujve prej druri.	31,4	83,7	94,5	100,0	86,2
21	Prodhimi i brumit të letrës dhe artikujve prej letre	3,7	100,0	100,0	100,0	100,0
24	Prodhim i kemikaleve dhe produkteve kimike	27,6	86,7	103,0	102,5	84,5
25	Prodhimi i produkteve prej gome dhe plastike	67,1	96,1	93,1	97,0	99,7
26	Prodhimi i produkteve të tjera minerale jo metalike	139,1	100,7	100,0	98,9	100,9
27	Prodhimi i metaleve	27,7	92,3	98,4	100,2	92,6
28	Prodhimi i produkteve prej metaleve përveç makinave dhe pajisjeve	35,8	125,5	105,3	103,4	120,3
29	Prodhimi i makinave dhe pajisjeve	20,1	119,5	100,0	104,7	118,2
31	Prodhimi i makinave dhe aparateve elektrike	3,0	95,2	100,0	98,4	95,6
35	Prodhimi i mjeteve të tjera të transportit	1,5	103,2	100,0	107,7	96,8
36	Prodhimi i mobileve ,industria tjetër përpunuese	15,1	99,1	100,0	100,0	99,1
40	Furnizimi me energji elektrike, me gaz, avull dhe me ujë të ngrohët	271,4	111,2	100,1	100,5	111,0
41	Mbledhja, pastrimi dhe shperndarja e ujit	30,9	112,8	100,0	100,0	112,8

Definicioni dhe qëllimi i IÇP

Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP) është tregues relativ që mat shkallën në të cilën çmimet e mallrave (prodhimeve) të prodhuara dhe shërbimeve ndryshojnë në periudha të caktuara kohore. Kryesisht si parametër statistikor ka një rëndësi të veçantë si deflator i Bruto Prodhimit Vendor me qasjen e prodhimit.

Metodologjia

Çmimet dhe vlera e prodhimeve indusriale janë grumbulluar nga ndërmarrjet prodhuese më reprezentative në Kosovë. Vlera e prodhimit dhe çmimi mesatar vjetor janë TM_1 për vitin 2007, ndërsa nga TM_1 për vitin 2008 bëhet grumbullimi i rregullt në kontinuitet për çdo tremujor.

IÇP - Indeksi i çmimeve të prodhimeve është në përputhshmëri me Klasifikimin Standard të Veprimtarive sipas NVE rev.1, është në zhvillim e sipër. Nuk janë të përfshira shumë aktivitete ekonomike që janë të varura nga zhvillimi ekonomik i vendit dhe gjindet me Standardet e Bashkimit Europian.

IÇP - është i llogaritur për 18 aktivitete ekonomike, nga 97 ndërmarrje prodhuese, për më tepër se 290 artikuj. Si projekt (GOPA - ESK) ka filluar gjatë vitit 2007 me qëllim që të krijohen baza elementare për themelimin e hulumtimit të IÇP-mit, ndersa nga mesi i vitit 2010 është duke u mbështetur nga SIDA suedeze.

Peshat specifike janë të llogaritura nga vlera prodhuese e grumbullar për këtë hulumtim nga viti 2007 në mungesë të të dhënave mbi statistikat e vëllimit të prodhimit dhe këto pesha nuk paraqesin vlerën prodhuese të tërësishme të vendit. Për kalkulimin e IÇP-mit për tremujorin e parë 2011 janë përdor peshat specifike të rifreskuara, e me të njejtat pesha është rikalkuluar i tërë IÇP-mit për vitin 2010. Me këte rast paraqiten ndryshime që dallojnë nga Indekset e publikuara më parë (si preliminare).

Për llogaritjen e IÇP-mit në kuadër të aktiviteteve ekonomike është përdorë formula e Lasperit.

Agregimi deri në IÇP në tërësi

$$PPI_0^q = 100 * \sum_{g=1}^{h} w_g * I_{0,g}^q$$

$PPI_0^q =$ Indeksi i çmimeve të prodhimit në mes tremujorit 0 dhe tremujorit q

$w_g =$ Pesha për grupe

$I_{0,g}^m =$ Shkalla e çmimit për grupin g mes tremujorit 0 dhe tremujorit q

$h =$ Numri i aktiviteteve ekonomike sipas NACE REV.1

Llogaritja e indeksit zingjiror të IÇPI

$$PPI_{2007}^{Y,q} = \frac{PPI_{2007}^{Y-1,4}}{100} * PPI_0^{Y,q}$$

$PPI_{27007}^{Y,q} =$ Indeksi zingjiror i IÇP mes 2007 dhe tremujorit q në vitin aktual

$PPI_{2007}^{Y-1,4}$ = Indeksi zingjiror i IÇP mes 2007 dhe tremujorit të katërt në vitin paraprak

$PPI_{0}^{Y,q}$ = Indeksi i Çmimit të prodhimit mes tremujorit 0 dhe tremujorit q në vitin aktual

Llogartija e ndryshimeve

Ndryshimi në mes tremujorit q dhe tremujorit q-1 është kalkuluar si vijon:

$$\left[\left(\frac{PPI_{0}^{Y,q}}{PPI_{0}^{Y,q-1}}\right)-1\right]*100 =$$ Përqindja e ndryshimit tremujor

$PPI_{0}^{Y,q}$ = Indeksi i çmimeve të prodhimit për tremujorin aktual q

$PPI_{0}^{Y,q-1}$ = Indeksi i çmimeve të prodhimit për tremujorin paraprak q-1

Ndryshimi vjetor kalkulohet si :

$$\left[\left(\frac{PPI_{2007}^{Y,q}}{PPI_{2007}^{Y-1,q}}\right)-1\right]*100 =$$ Përqindja e ndryshimit vjetor

$PPI_{2007}^{Y,q}$ = Indeksi i çmimeve të prodhimit industrial për tremujorin aktual q

$PPI_{2007}^{Y-1,q}$ = Indeksi i çmimeve të prodhimit industrial për vitin dhe tremujorin paraprak q

Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

Enti i Statistikës së Kosovës, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.
Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Enti i Statistikës së Kosovës vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

Struktura organizative e ESK-së, katër Departamente prodhuese (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), shtatë Zyra Rajonale (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), dy Departamente mbështetëse (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe Zyra e regjistrimit të popullsisë, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës.
Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .
Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.
Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistrues terreni nga Zyrat Rajonale.
Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

Misioni i Entit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa: Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë**
- **Telefonat:**

Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111
Drejtori: +381 (0) 38 235 545 ose +381 (0) 38 504 604 lok. 6572
- **Fax: +381 (0) 38 235 033**
- **E-mail: economic@ks-gov.net**
- **Ueb-faqe: www.ks-gov.net/esk**